



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2018:034457

Datë: 15.03.2021

Numri i dokumentit: 01596012

PKR . nr.141/13

NE EMER TE POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NE PEJE – DEPARTAMENTI PER KRIME TE RENDA , Kryetari i trupit gjykues Sami Sharaxhiu , me pjesëmarrjen e sekretares juridike Lulavere Mala , në çështjen penale, ndaj te pandehurit K. H. Nga , për shkak te veprës penale , mbajtja në pronësi , kontroll, posedim apo shfrytëzim të paautorizuar të armëve , nga neni 328 par.1 te KPK-së , sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë-Departamenti për Krime të rënda , PP .nr.336/10 , të dt. 09.12.2010 , ne shqyrtimin gjyqësor të mbajtur në prezencën e Prokurorit të shtetit Haxhi Sinanaj , të akuzuarit K. H. si dhe mbrojtësit të tij sipas detyrës zyrtare , av. Sh. M. nga , me date. 13.03.2021 muarr , ndërsa me datën 15.03.2021 , punoi këtë :

AKTGJYKIM

I PANDEHURI

K. H. , i lindur me dt. në , ku edhe jeton, lagja , rr. “.....” nr. 13, me vendbanim të përkohshëm në , i biri R. dhe M. e gjinisë I. , ka të kryer shkollën e mesme , i divorcuar – baba i tre fëmije . punëtor , i njohur sipas numër personal , i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar , shtetas i Republikës së Kosovës , gjendet në liri.

ËSHTË FAJTOR

Për shkak se:

Më parë ka siguruar dhe gjer me dt.08.08.2010, rreth orës 13.00 minuta, pa autorizim ka mbajtur armë dhe municion dhe atë një armë automatike AK-47 me nr. serik 17102461, prodhim kinez, kalibër 7.62 mm, si dhe një karikator dhe 92 copë fishek të kalibrit 7.62 mm, e cila armë dhe municion, iu gjetën dhe iu konfiskuan nga ana e njësitit të policisë, ditën kritike me rastin e kontrollimit të automjetit të tipit “.....”, me ngjyrë të zezë, me nr. të tabelave , i cili automjet ka qenë i parkuar në oborrin e restorantit “.....”, në fsh.....-të-K....., e me të cilën armë , në parkingun e restorantit në fjalën, kishte shtënë disa herë duke shkaktuar pasiguri tek të pranishmit.

- me çka ka kryer veprë penale, mbajtja në pronësi, kontroll, posedim apo shfrytëzim të paautorizuar të armëve, nga neni 328 par.1 të KPK-së .

Andaj, gjykata, konform nenit 1, 6,31, 32, 33, 34, 35, 36 par.3, 39, nenit 328 par. 1 si dhe nenit 328 par.5 të KPK-së, të pandehurin K. H. , e gjykon me:

DËNIM ME GJOBË

Ashtu që ia shqipton dënimin me gjobë, në shumë prej **400 (katërqind) Euro**, e të cilin dënim me gjobë, i pandehuri, është i obliguar që ta paguaj **në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh** nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi, e po që se i pandehuri nuk e paguan dënimin me gjobë në afatin e caktuar, dënimi me gjobë i zëvendësohet me dënim me burg e ku një ditë burgu i llogaritet në shumë prej 20 (njëzet) Euro.

Konform nenit 328 par.5 të KPK-së, të pandehurit i shqiptohet dënimi plotësues , me të cilin, një armë automatike AK-47 me nr. serik 17102461, prodhim kinez ,kalibër 7.62 mm, si dhe një karikator dhe 92 copë fishek të kalibrit 7.62 mm, **konfiskohen** dhe pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, urdhërohet që të shkatërrohen.

Obligohet i pandehuri, që në emër të shpenzimeve të procedurës penale, gjykatës të ia paguaj shumën prej 25 (njëzet e pesë) Euro, në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësorë, shumën prej 25 (njëzet e pesë) Euro si dhe në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit , shumën prej 50 (pesëdhjetë) Euro, e të gjitha këto në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

PTHDKR ne Peje , ndaj të pandehurit K. H. nga , ka ngritur aktakuzë , për shkak të veprës penale, mbajtja në pronësi , kontroll, posedim apo shfrytëzim të paautorizuar të armëve, nga neni 328 par.1 të KPK-së , me propozim që të caktohet shqyrtimi gjyqësor , të administrohen provat dhe pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor , i pandehuri të shpallet fajtor , të dënohet sipas ligjit , dhe të obligohet në paguarjen e shpenzimeve të procedurës penale , ndërsa arma dhe municioni si mjete me të cilat është kryer vepra penale të konfiskohen dhe pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit të urdhërohet që të shkatërrohen.

I akuzuari , ne shqyrtimin fillestar te mbajtur me datën 13.03.2021 , pas leximit te aktakuzës dhe precizimit të saj nga ana e prokurorit të shtetit, e ka pranuar fajësinë për veprën penale për te cilën akuzohet sipas aktakuzës , dhe këtë veprim e ka bere ne baza vullnetare, pas konsultimit me mbrojtësin e tij , dhe i pandikuar nga askush.

Prokurori i shtetit Haxhi Sinanaj, lidhur me pranimin e fajësisë ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë sa i përket të pandehurit K. H. , i cili e ka pranuar fajësinë për veprën penale të kryer dhe i njëjti pranim bazohet në provat që i kemi në shkresat e lëndës.

Mbrojtësi i të pandehurit, av. Sh. M., lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të mbrojturit të tij, ka deklaruar se me që ky pranim është bërë në baza vullnetare dhe pas konsultimit me mua, i propozoj gjykatës që ta aprovoi pranimin e fajësisë nga ana e të mbrojturit tim dhe njëherit këtë pranim fajësie me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin, ta merr si rrethanë lehtësuese.

Gjykata, duke vlerësuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit , ka ardhur në përfundim se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore që burojnë nga dispozita ligjore e nenit 246 te KPPRK-së , dhe konform nenit 248 par.4 lidhur me par.1 te KPPRK-së , e ka aprovuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit.

Pasi që i pandehuri e ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barë sipas aktakuzës , gjykata , duke nisur nga pranimi i fajësisë si dhe pas shqyrtimit të shkresave të lendes , ka ardhur në përfundim se në veprimet e të pandehurit K. H. , ekzistojnë të gjitha elementet e veprës penale , mbajtja në pronësi , kontroll, posedim ose shfrytëzim të paautorizuar të armëve , nga neni 328 par.1 të KPK-së , dhe njëherit para se të kalojë në marrjen e vendimit mbi dënimin i ka ftuar palët në procedure që të deklarohen lidhur me fjalën përfundimtare.

Prokurori i shtetit Haxhi Sinanaj në fjalën përfundimtare ka deklaruar se meqenëse i pandehuri K. H. e ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barë, i propozoj gjykatës që i njëjti të shpallet fajtorë, të dënohet sipas ligjit dhe të obligohet në paguarjen e shpenzimeve të procedurës penale, ndërsa arma me të cilën është kryer vepra penale të konfiskohet dhe e njëjta pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit të urdhërohet që të shkatërrohet.

Mbrojtësi i të pandehurit Kushtrim , Av.Sh. M., në fjalën përfundimtare ka deklaruar se meqë i mbrojturi im e ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barë, i propozoj gjykatës që këtë pranim ta merr si rrethanë posaçërisht lehtësuese dhe të mbrojturit tim të i shqiptoj një dënim sa më të lehtë mundësisht me gjobë.

I pandehuri K. H. në fjalën përfundimtare ka deklaruar se në tërësi pajtohem me fjalën përfundimtare të mbrojtësit tim, njëherit më vjen keq për rastin e ndodhur dhe i premtoj gjykatës që në të ardhmen nuk do të ndodhë që të kryej vepër penale.

Gjykata, me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin, konform nenit 66 të KPK-së, i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe atë rënduese për pandehurin, si rrethanë lehtësuese gjykata mori për bazë pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, sjelljen e tij të mirë, mos dënueshmërinë e tij të gjertanishme, ndërsa rrethana rënduese gjykata nuk gjeti , andaj edhe ia shqiptoi dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, e bindur thellësisht se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i sanksionit penal dhe i pandehuri do të parandalohet që në të ardhmen të kryej ndonjë vepër tjetër penale.

Gjykata, konform nenit 450 par.1 dhe 2 të KPPRK-së, të akuzuarin e ka obliguar në paguarjen e shpenzimeve të procedurës penale dhe të paushallit gjyqësorë, ndërsa konform ligjit nr. 05/L-036, e ka obliguar në paguarjen e taksës për kompensimin e viktimave të krimit.

Gjykata , konform nenit 328 par. 5 të KPK-së,të akuzuarit ia ka shqiptuar dënimin plotësues me të cilin armët dhe municioni , të përshkruara në dispozitiv të aktgjykimit, konfiskohen dhe pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi të njëjta është urdhëruar që të shkatërrohen.

Andaj, nga sa u tha më lartë, është vendosur sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË-DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA-
PKR.nr.141/13-DT.15.03.2021.**

Sekretarja juridike

Kryetari i trupit gjykues

Lulavere Mala

Sami Sharaxhiu

KËSHILLË JURIDIKE

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15(pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e pranimi, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë e përmes kësaj gjykate.